

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 52 nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1366/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1670/8 datë 10.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, për shkeljen e kryer të nenit 52 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që në kuadër të shërbimit programor televiziv, të transmetuar më 4 mars 2025, në emisionin „Thirre 21-shin (Повикај ро 21)“ – aktuale – emision aktual informativ argëtues në të cilin ka mundësi dhe për pjesëmarrje shpërblyese të shikuesve, ofruesi i shërbimit mediatik audiovizual nuk ka siguruar një shpallje të qartë të rregullave, as informacion për çmimin e premtuar publikisht. Njoftimin që e ka publikuar në faqen e internetit nuk përmban informacionin e nevojshëm të përcaktuar nga Agjencia në aktin nënligjor – Rregulloren për programet me pjesëmarrje shpërblyese dhe për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1366/1 datë 27.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe Rregulloren për programet me pjesëmarrje shpërblyese dhe për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij llogaritet dita e certifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe të të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë – vërejtje publike në rastet kur ka shkelje ose cënim të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në

bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 52 të LSHMAAV, ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizuele gjatë transmetimit të kuizeve ose formave të tjera të pjesëmarrjes në shpërblime për shikuesit, është i detyruar të sigurojë publikimin e qartë të rregullave për përmbajtjet dhe për shpërblimin publik të premtuar, në mënyrën e përcaktuar nga Agjencia.

Sipas nenit 3 (Rregullat për organizimin e programeve me pjesëmarrje shpërblyese) paragrafi (1) i Rregullores për programet me pjesëmarrje shpërblyese dhe përdorimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar, ofruesi i shërbimit mediatik audiovizual, për transmetimin e programeve me pjesëmarrje shpërblyese, është i detyruar të përvetësoj rregullat që i publikon në ueb-faqen e internetit dhe informon Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele. Rregullat e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele duhet të përmbajnë dispozita për aspektet në vijim të programit: përshkrim të grupit të shikuesve për të cilët është destinuar programi konkret, përshkrim i detajuar i mënyrës së pjesëmarrjes në program dhe mënyra e fitimit të çmimit, shpenzimet e pjesëmarrjes në program, kufizimet e mundshme për pjesëmarrje në programin të individëve (për shembull: të punësuar tek ofruesi i shërbimit dhe anëtarët e familjeve të tyre dhe të ngjajshme), kufizimet e mundshme të përgjithshme për pjesëmarrje në program: kohëzgjatja e lojës/garimit, numri maksimal i pjesëmarrësve, numri maksimal i pjesëmarrësve gjatë një edicioni të programit, periudha kohore që duhet të kalojë për pjesëmarrjen në program pas marrjes së shpërblimit dhe të ngjajshme, mënyra se si ndahet shpërblimi fituesit, vlera mesatare e shpërblimeve që ndahen në program, mënyra se si shpallen fituesit në garim ose lojë, mënyra se si shikuesit njoftohen për përfundimin e lojës, mënyra dhe periudha në të cilën shpërblimi i dorëzohet fituesit pa shpenzime plotësuese, përkatësisht procedura në të cilën fituesi mund të kërkon t'i dorëzohet shpërblimi, mënyra se si operohet me të dhënat personale të pjesëmarrësve në program dhe fituesit e shpërblimeve (paragrafi 2 nga neni i njëjtë i Rregullores).

Në nenin 4 (informimi i shikuesve dhe dëgjuesve për rregullat) paragrafi (1) i Rregullores në fjalë, ofruesi i shërbimit mediatik audiovizual, gjatë transmetimit të programeve me pjesëmarrje shpërblyese, duhet të informojë qartë dhe pa mëdyshje shikuesit së paku për: mënyrën sheshpenzimet për pjesëmarrje në program, kufizimet për pjesëmarrje në program, llojin e shpërblimit, mënyrën e dhënies dhe mënyrën, periudhën e dorëzimit të shpërblimit deri tek fituesi dhe të përkujton se rregullat e plota për pjesëmarrje në program ose në pjesë të saj mund të gjenden në ueb faqen e ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore më 27 mars 2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, transmetuar më 4 mars 2025, në nivel shtetëror, ku është konstatuar shkelje e nenit 52 të LSHMAAV, të mënyrës që në shërbimin programor të datës 4 mars 2025, në emisionin „Thirre 21-shin (Повикај го 21)“, emisionin aktual-informativ folës, në të cilën ekziston mundësia dhe për pjesëmarrje shpërblyese të shikuesve, SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup nuk ka ofruar publikim të qartë të rregullave, si dhe informacione për shpërblimin e premtuar publikisht, siç parashihet në „Rregulloren për programe me pjesëmarrje shpërblyese dhe për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar“. Njoftimi, nga ana tjetër, të cilin e ka publikuar në ueb faqen e internetit, nuk përmban informacionin e nevojshëm të përcaktuar në aktin nënligjor – Rregulloren për programet me pjesëmarrje shpërblyese dhe për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar.

Shkelja nga paragrafi (1) të këtij Vendimi, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1366/1 datë 27.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, me datë 28.03.2025, ka dërguar Shkresë ark.nr.10-1366/2 datë 28.03.2025, me të cilën i dorëzoi dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1366/1 datë 27.03.2025, që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoj deklaratë me shkrim për

shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa është pranuar nga transmetuesi me datë 28.03.2025. Në afatin e parashikuar SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 10.04.2025, shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konkludoi që SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP t'i shqiptojë masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 52 nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1366/1 datë 27.03.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1670/8 datë 10.04.2025, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV dhe Rregulloren për programet me pjesëmarje shpërblyese dhe për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-1366/1 datë 27.03.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit.